



### SINTEZË E PERIUDHËS 5 Pril-13Prill

**Qeverisja Demokratike: Qeverisja Demokratike:** Këshillat bashkiake kanë intensifikuar vendim-marrjen përmes mjeteve online dhe ndërmarrë veprimtari mbikqyrëse. Vëmendje I është kushtuar sidomos procesit të shpërndarjes së ndihmave, patronazhimit apo vullnetarizmit dhe kontrollit të listave të përfituesve. Vendimarrja online ka funksionuar mirë në 54 bashki jo vetëm për aspekte të emergjencës, por edhe të aprovimit të rregulloreve të funksionimit. Vetëm javën e shkuar janë aprovuar 11 rregullore të funksionimit në 4 këshilla vendore. Përditësimi me njohuri me formatet e reja teknologjike të komunikimit ka lejuar të vazhdojë dhënia e asistencës teknike e programuar nga projekti Bashki të Forta, (këtë javë 16 Kryetarë dhe Sekretarë këshilli, morën pjesë në trajnime ditore). Risi përbën tentativa në rritje për më shumë transparencë dhe monitorim nga këshillat bashkiakë mbi aktivitetin e ekzekutivit me menaxhimin e situatës, ku disa këshilla e kërkojnë në formë ditore këtë informacion.

### Bashkëpunimi Kombëtar-Rajonal-Vendor:

Në fokus të kesaj jave ka qenë identifikimi i grupeve apo personave të angazhuar në sektorin informal për t'u përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike. Është zgjeruar bashkëpunimi me zyrat e tatimeve, zyrat e punës apo pikave kufitare si dhe me administratorët vendor dhe organizata komunitare për identifikimin e tyre.. Prefektë kanë treguar rol aktiv në nxitjen e përshpejtimin e disa procedurave administrative, por edhe duke bashkëpunuar më intensivisht me bashkitë në menaxhimin e ndihmës. Rol aktiv këtë javë ka patur dhe Ministria e Brendshme në monitorimin e udhëzimeve për menaxhimin e situatës në terren. Qarqet janë vënë në mbështetje të komuniteteve vendore.

### Transparencë dhe Llogaridhënie:

Bashkitë kanë intensifikuar komunikimin me publikun nëpërmjet medias tradicionale dhe sociale mbi aktivitetin e tyre në përballimin e situatës. Për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve është mundësuar aplikimi online apo marrja dhe zgjidhja e ankesave nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë. Në Korçë ka filluar pilotimi i një sistemi për menaxhimin e ndihmës nga terreni në kohë reale nëpërmjet formularëve elektronik. Në Shkodër u shënuar transmetimi live në media lokale dhe sociale i mbledhjes së këshillit bashkiak.

**Përbushje e Funksioneve Vendore:** Përveç fokusit të shpërndarjes së ndihmës, bashkitë këtë javë janë impenjuar për të riorganizuar tregjet e prodhimeve bujqësore (sidomos ato urbane) duke vendosur tregje të levizshme, fuqizuar zbatimin e rregullave, shenjëzuar qarkullimin për ruajtjen e distancës sociale, tunele disinfektuese

etj. Një pjesë e mirë e bashkive ka filluar shpërndarjen e fazes së dytë të ndihmave. Në funksion të shërbimeve sociale apo dhe sigurisë bashkitë kanë vënë në dispozicion punonjës socialë, mjete të tyre transportit apo dhe kanë gjetur mënyra novatore për të lehtësuar efektet negative mendore të mbylljes në shtëpi përmes aktiviteteve kulturore dhe këshillimit psiko-social. Veç sigurimit të shërbimeve të lidhura ngushtë me emergjencën (shërbimet sociale, desinfektimit etj), bashkitë kanë filluar të rimbolizohen edhe për për shërbime të tilla si ato që lidhen me turizmin (pastrimi i plazheve dhe vend-depozitimeve) dhe bujqësinë. Në përgjithësi të gjitha bashkitë janë duke punuar për krijimin e formave zbatuese për qytetarët e të gjitha grupomoshave.

### Kontribut i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore (AMVV) dhe Shoqatave të Pushtetit Vendor:

AMVV ka vazhduar mbështetjen e Njësitë të Qeverisjes Vendore (NJQV) në zbatim të akteve të dala nga Ministria e Financave apo ministri të tjera të përfshira në menaxhimin e situatës. AMVV ka shpërndarë tek bashkitë rregulloret e reja tip për këshillat bashkiake dhe në koordinim me Ministrinë e Arsimit Manualin e Arsimit Parashkollor. Agjencia dhe Shoqata për Autonomi Vendore koordinojnë grupin e kryetarëve për monitorimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 236, datë 19.03.2020 "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"

Shoqata për Autonomi Vendore nga ana e saj vijon të advokojë mbi nevojën për të përfshirë në listat e njerëzve në nevojë edhe personat që rezultojnë si të papunë pas 11 Marsit dhe ka ndikuar në përshpejtimin e procedurave të pagesës nga thesari.

Shoqata e Bashkive ka sugjeruar një pjesëmarrje më në rritje të NJQV në administrimin e situatës bazuar në konceptin e lokalizimit, duke shtuar përgatitjen e stafit të bashkive me protokolle të posaçme për përballimin e emergjencës. Të dy shoqatat kanë qenë aktive në pjesëmarrjen në rrjete rajonale e më gjerë për të shkëmbyer përvoja në lidhje me përballimin e krizës.

### PËR MË SHUMË INFO KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL

[Kliko këtu](#)

## QEVERISJE DEMOKRATIKE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
<p><b>Vendimmarrja</b> Përdorimi i mjeteve elektronike &amp; pamundësi për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit në kushtet e "distancës sociale"</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorim i platformave online për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit nga 55 bashki. 33 prej tyre përdorin platforma aktive komunikimi me figure dhe zë (zoom, skype etc) ndërsa 22 kanë përdorur forma më pasive (messenger apo whatsapp). Projekti "Bashki të Forta" ka asistuar 12 këshilla bashkiak në mënyrë të drejtëpërdrejtë për përdorimin e platformave aktive këtë javë, duke përdorur udhëzuesin e përgatitur nga projekti për mbledhjet online.</li> </ul>	Mbeten ende mbledhje online për tu zhvilluar në (Selenicë, Finiq, Kamëz, Kavajë, Konispol, Pustec)
Efektet e krizës tek njerëzit në nevojë (veçanërisht gratë) dhe biznesi, shërbime	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtyrje e afatit për pagesat e taksave dhe tarifave vendore ose zerim i tyre për bizneset vendore.</li> <li>Lehtësira fiskale për kategori të ndryshme sociale. Zerim i qerasë për përdoruesit e banesave sociale</li> </ul>	Berat, Lezhë, <b>Kolonjë, Pogradec, Kukës, Durrës</b>  Lezhë, <b>Korcë, Durrës</b>
<p><b>Mbikqyrja</b> Monitorimi i grupeve të patronazhit në terren mbi shërbimin që ofrohet</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përpjekje për fuqizimin e rolit mbikqyrës të këshillit për efektivitetin e menaxhimit të ndihmave: këshillim për formulim më transparent të projekt vendimeve (veçanërisht ato që lidhen me ndihmat). BtF e gatshme për të ndihmuar.</li> <li>Raportim i ekzekutivit për Këshillin Bashkiak (online) mbi procesin e shpërndarjes dhe listën e përfituesve.</li> </ul>	Gramsh, Këlcyrë, Libohovë, Patos, Lushnje, Shijak, Mallakastër, Divjakë, Roskovec, Kolonjë, Maliq, Pustec, Durrës, Pogradec, <b>Rrogozhinë, Kukës, Dibër, Mat, Klos, Bulqizë, Delvinë,</b>  <b>Pogradec, Kolonjë, Devoll,</b>
<p><b>Veprime të tjera</b> Aktiviteti i këshillit kufizuar vetëm për aspekte të emergjencës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Asistencë teknike nëpërmjet trajnimeve ditore online (<a href="#">kliko këtu</a>) për Kryetar dhe sekretar të keshillave bashkiak (16 pjesmarrës). Fokus i trajnimit ishte "Rregullorja e funksionimit të këshillit", "Rregullorja e Konsultimeve me Komunitetin", "Hartimi i Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak dhe Buxhetimit".</li> <li>Miratohen 3 "Rregullore e funksionimit të Këshillit", 4 "Rregullore të Konsultimeve me Komunitetin" dhe 4 "Kod i sjelljes dhe Etikës" në mbledhje online të këshillit.</li> <li>Këshilltarët krahas rolit vendimarrës dhe monitorues vazhdojnë angazhimin në grupet e patronazhit si vullnetarë</li> </ul>	<b>Diber, Klos, Mat, Bulqize, Durres, Kelcyre, Mallakaster, Berat, Kolonje dhe Roskovec</b>  <b>Urë Vajguore, Himarë, Dibër, Mirditë,</b>  Lezhë, Gjirokastrë, Dropull, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë, Përmet, Këlcyrë, Shijak, Kurbin, Mirëditë, Durrës, Pogradec, Kolonjë, Maliq, Lushnje, <b>Rrogozhinë, Gramsh,</b>

## BASHKËPUNIMI KOMBËTAR-RAJONAL-QEVERISJE VENDORE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
Identifikimi i njerëzve në nevojë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkitë fillojnë t'i paraprijnë hartimit të listave për fashat e njerëzve që mund të dalin të papunë nga kohëzgjatja e emergjencës. Përpilimi I listave po hartohet me informacionin e përfutur nga listat emerore të tatimeve, zyra të punës si dhe pikat kufitare.</li> </ul>	Shkodër, <b>Vlorë</b>
Kordinim për veprim efektiv	<ul style="list-style-type: none"> <li>Projektet Bashki të Forta dhe Financat Lokale mbështesin me rekomandime konkrete Agjencinë për Mbështetje e Vetëqeverisjen Vendore (AMVV) për rishikimin e tarifave për bizneset vendore si dhe mbi mundësitë e rishikimit të tarifave bashkiake.</li> <li>Bashki të ndryshme vënë theksin tek nevoja për të analizuar më mirë hapsirat që kanë për rialokime, duke kërkuar asistencë të dedikuar nga projektet "Bashki të Forta" &amp; "Financat Lokale"</li> <li>Koordinim i efektiv i zinxhirit prefekt-këshill-administratë për konfirmimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak duke ofruar edhe udhëzime dhe urdhëra për vendimarrje në përputhje me luadrin ligjor. Ngritja e grupeve të punës për monitorimin e shpërndarjes së ndihmës në terren.</li> <li>AMVV i shpërndan bashkive "Draft Rregulloren e Këshillit Bashkiak për Strukturat Komunitare" dhe "Draft Rregulloren e KB për trajtimin e Peticioneve, dhe Nismave qytetare" si dhe Manualin e Arsimit parashkollor të hartuara nga ekspertiza e ofruar nga "Bashki të Forta".</li> <li>Angazhim i në terren i Qarkut në shpërndarje me ndihma duke bashkërenduar punën edhe për shtresat sociale me nevoja të veçanta (familje të prekura nga spektri autik etj)</li> <li>Prefekti koordinon takimin për të lehtësuar barrierat doganore Shqipëri-Kosovë për shkak të emergjencës dhe ndalimit të tregtimit të produkteve të fermerëve shqiptarë në BE.</li> <li>Koordinim i ndihmave të mbledhurar nga Prefektura me Bashkinë për shpërndarje duke ju referuar listave të njerëzve në nevojë sipas prioriteteve të identifikuar nga administrata bashkiake.</li> </ul>	<p style="color: red;">61 Bashki</p> <p style="color: red;">Gjirokastrë, Krujë, Mat, Përmet</p> <p style="color: red;">Prefektura Korçë, Prefektura Fier, Prefektura Durrës, Prefektura Elbasan</p> <p style="color: red;">61 Bashki</p> <p style="color: red;">Qarku Tiranë, Qarku Gjirokastrë</p> <p style="color: red;">Kukës</p> <p style="color: red;">Dibër, Gramsh</p>

- Sugjerim i shoqatave të biznesit lokal për incentivimin e punonjësve informal në legalizimin e marrëdhënies së punës së tyre nëse përfitojnë nga pagesa e "Luftes" (aplikuar psh. Kosovë) **Kukës**
- Marrëveshje e përbashkët mes bashkisë dhe ZVAP për këshillimin online psiko-social të fëmijëve 3-6 vjec, realizuar me mbështetjen e BtF. Kjo praktikë do të shpërndahet në të gjitha bashkitë me asistencën e BtF. **Durrës**

## TRASPARENÇË, NDËRGJEGJËSIM DHE LLOGARIDHËNIE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
Informacion i mjaftueshëm për të përfituar shërbimet publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Transmetim live i mbledhjes së këshillit bashkiak në platforma të medias sociale dhe në TV lokale në respektim të udhëzimit të BTF.</li> <li>• Përdorim i platformave elektronike për trajtim ankesash ose dërgim aplikimesh për ndihmë ekonomike.</li> </ul>	Shkodër  Kukës, Berat, Tepelena, Progradec Korçe, Kolonje, Pogradec, Pustec, Devoll, Maliq, Durrës, Shijak, Krujë, Shkodër, <b>Përmet Memaliaj</b>
Nxitje e Vullnetarizmit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thirrje nëpërmjet FB ndaj qytarëve, të atashohen si vullnetarë në njësinë administrative ku jetojnë, si dhe nisma për vullnetarë të angazhuar në përkujdesjen ndaj të moshuarve (Adopto një Gjysh etj); përdorim i medias sociale për të promovuar emrat e dhuruesve.</li> <li>• Asistencë për familjet në nevojë apo të moshuarit e vetmuar për shërbime bazë, ndihmë ushqimore, ushqim të gatuar apo ilaçe duke koordinuar mes grupeve të patronazhit dhe vullnetarëve.</li> <li>• Bashkia krijon formular online dhe aplikacione për ndihma apo shërbime nga bashkia apo sektori privat</li> </ul>	Gjirokastrë, Klos, Lezhë, Kukës, Has, Tropojë, Durrës, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Tirana, Korçë, Berat, <b>Dropull, Shijak, Pogradec, Kolonjë, Maliq, Gramsh</b>  Kurbini, Lezhë, Divjake, Lushnje, Patos, Roskovec, Durrës, Shijak Krujë, Elbasan, Vlorë, Finiq, Konispol, Sarandë, Himarë, Delvinë, <b>Devoll, Gjirokastrë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull, Tepelenë, Memaliaj, Fier, Mallakastër, Kukës, Pogradec, Kolonjë, Korçë, Pustec, Gramsh</b> Tirana (Aplikacion, Nr, Gjelbër) <b>Kukës</b>
Informim i publikut mbi punën dhe masat e mara në nivel bashkie	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Raportim i punës së zhvilluar nga të gjitha strukturat e bashkisë ofrohen në faqen e facebook-ut dhe medias lokale.</li> <li>• Pilotim i një sistemi me formular online (prodhuar nga Ministria e Brendshme) për regjistrimin e ndihmës në kohë reale dhe i integruar me sistemet digjitale lokale të shtabit të emergjencës.</li> <li>• Kërkohet nga Ministria e Brendshme përdorimi i certifikatës personale gjeneruar nga e-Albania për kryerjen e veprimeve deri në përfundim të emergjencës, për personat të cilëve I ka skaduar afati i letërnjoftimeve digjitale. Kërkesë adresuar Bankës Qëndrore dhe atyre të nivelit të dytë.</li> </ul>	Pukë, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Vau i Dejës, Shkodër, Durrës Shijak, Krujë, <b>Devoll, Pogradec, Pustec, Kolonjë, Korçë, Maliq, Kukës, Gramsh</b>  <b>Korçë</b>  Gjithë territori i vendit

## PËRMBUSHJA E FUNKSIONEVE VENDORE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
<p><b>Shërbimet Sociale</b> Fonde te pamjaftueshme për të përballuar emergjencën COVID me burimet e alokuara financiare në buxhetet vjetor (veçanërisht në mbështetje të shtresave në nevojë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje e familjeve në nevojë, rome/egjiptiane apo ato të goditura nga tërmeti, me ushqime dhe materiale të nevojshme të ofruara nga fondet e bashkive, donacione private ose fetare (Fondacioni Ndhim për fëmijët, Kryqi i kuq, Uji i ftohtë, Nehemia Gateway, CFN Albania, Save the Children, A2B Albania, World Vision, La Luce dell'est dhe Rrahma Mercy, RomActed, Ferra &amp; CO)</li> </ul>	<p>Lezhë, Berat, Lushnje, Pogradec, Pustec, Durrës, Shijak, Elbasan, Patos, Mallkastër, Dibër, Krujë, Përmet, Shkodër, <b>Fier, Kolonjë, Gramsh</b></p>
<p>Ofrim shërbimesh sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vënie në dispozicion të mjeteve të transportit bashkiak për nevoja furnizimi me bazë ushqimore (bluarje e grurit për zona rurale)</li> <li>Shpërndarja e mesazheve sensibilizuese për dhunën në familje, në kohën e COVID-19 dhe ofrimi i numrave të punonjësve social të bashkisë dhe aplikacioni për denoncime apo ndjekje rastesh dhune.</li> <li>Ndhimë ushqimore apo materiale higjienike për gratë e dhunuara, pa përkrahje që jetojnë vetë.</li> <li>Telefonata ditore për mbështetje psikologjike për të moshuarit të jetojnë vetëm.</li> </ul>	<p><b>Pustec</b></p> <p>Dibër, Klos, Malesi e Madhe, Fushe Arrez, Shijak, Lushnje, Selenicë, Himarë, <b>Pogradec, Lezhë, Durrës, Gramsh</b></p> <p><b>Pogradec, Kucovë</b></p> <p><b>Dropull.</b></p>
<p>Evidentimi i familjeve ne nevojë dhe dërgimi i listave pranë Komitetit të Emergjencave</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krijimi i procedurave të brendshme për menaxhimin e zinxhirit të shpërndarjes së ndihmës duke u siguruar për evidentimin e njerzëve në nevojë dhe parandalimin e zinxhirit te infeksionit. Bashkitë bëjnë transparente shperndarjen e ndihmave ne këshill dhe publik.</li> <li>Thirje për sensibilizim drejtuar emigrantëve, bashkëatdhetarëve dhe bizneseve duke grumbulluar ndihma për familjet në nevojë.</li> <li>Ndihma ushqimore nga fondet e rialokuara për emergjencën tashmë po shpërndahen në fazën e dytë të ndihmës.</li> <li>Evidentim i sektorit informal të cilët nuk fitojnë nga paketa e ndihmës nga qeveria duke i orientuar drejtë skemës së ndihmës dhe përkrahjes sociale</li> <li>Asistencë për njerëzit që aplikojnë për herë të parë për ndihmë ekonomike</li> </ul>	<p>Shkodër, Dibër, Kukes, Has, Tropoje, Durrës, Shijak, Krujë, Mallakstër, Patos, Roskovec, <b>Kolonjë, Pogradec, Devoll, Kukës, Has, Tropojë, Dropull, Këlcyrë, Gjirokastër, Memaliaj, Libohovë, Përmet, Gramsh</b></p> <p>Mat, Kukës, <b>Klos, Përmet, Roskovec, Divjakë, Fier, Mallkastër, Patos, Lushnje, Pustec, Devoll</b></p> <p><b>Mat, Bulqizë, Klos, Dibër, Krujë</b></p> <p><b>Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Vlorë, Delvinë</b></p> <p><b>Fier, Lushnje Patos, Mallkastër, Roskovec, Divjakë, Gramsh</b></p>

- Shtohet nga të ardhurat e bashkisë fondi tavan i ndihmës ekonomike. Trajtohen me ndihmë ekonomike edhe familje që nuk janë pjesë e skemës (veçanërisht ato që i përkasin komunitetit rom).

Fier

### Siguria Publike

Përbushja e detyrave funksionale edhe në kohë emergjence

- Riorganizim i tregjeve publike në hapsirat ekzistuese ose dekoncentrim i tyre nëpër lagje, për të shmangur grumbullimin e konsumatorit në disa pika tregëtimi si dhe implementim i tuneleve, masave dizifektuese si dhe përdorimit të pajimeve mbrojtëse.
- Shenjëzim i dallueshëm në pika shërbimi tregtar për ruajtjen e distancës sociale.

Tiranë, Vlorë, Fier, Durrës

Tiranë, Dibër, Bulqizë, Mat, Klos, Durrës, Shijak, Korçë, Kurbin, Kuçovë, Berat, Urë Vajgurore, Vlorë, Sarandë, Pukë, Kukës, Has, Shkodër, Delvinë, Roskovec, Fier, Roskovec, Patos, Përmet, Gjirokastrë Elbasan, Gramsh, Librazhd, Cerrik

### Shërbime publike

- Bashkia propozon këshillit mbulimin e shpenzimeve funerale nga bashkia për viktimat e COVID-19
- Rifillimi i takimeve me grupet e punës (online) për zbatimin e planeve e menaxhimit të mbetjeve (mbështetur dhe koordinuar nga BTF)

Tiranë

Vau Dejës, Shkodër, Pukë, Librazhd, Prrenjas, Mirditë, Patos, Belsh, Divjake, Mallakster, Gramsh, Elbasan

### Veprimtari që vlijon si normalisht përtej COVID-19

- Pastrimi i disa vend depozitimeve ilegale të mbetjeve në njesite administrative. Përdorimi i situatës për të mbyllur punë publike infrastrukturore apo mirëmbajtje në kushtet e lëvizjes dhe transportit të lehtësuar nga COVID-19 (sheshe, trotuaresh, ujësjellësa)

Mat, Dibër, Durrës, Shijak, Bulqizë, Klos, Kukës, Has, Tropojë, Polican, Gjirokastrë, Memaliaj

### Aktivitetet Zbavitëse

- Konkurse që ndihmojnë të rinjtë dhe të rriturit në bashkëpunim me median lokale, apo duke zhvilluar aktivitete online nëpërmjet medias sociale dhe autoriteteve të kulturës.

Lezhë, Vlorë, Klos, Dibër, Kukës, Pogradec, Përmet, Patos, Lushnjë, Shijak

### Parashkollori

- Edukatorët ofrojnë programin mësimor dhe orë zbavitëse për fëmijët përmes medias online në bashkëpunim me prindërit.
- Vizita në shtëpitë e familjeve që nuk kanë akses ndaj internetit. Edukatorët zhvillojnë program mësimor për fëmijët duke ruajtur distancën e sigurisë

Durrës, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Krujë, Shijak, Kukës,

Kukës

**Shënim\*:** Me ngjyrë të kuqe janë bashkitë që janë shtuar apo që po replikojnë një praktikë të vënë në jetë më parë nga bashki të tjera.

**Shënim\*\*:** Një falenderim i veçantë shkon për mediat kombëtare apo lokale që e kanë shpërndarë raportin si dhe kanë evidentuar zgjidhjen e dhënë nga bashkitë për problematikat e krijuara gjatë emergjencës COVID-19